

LIGJ
Nr. 43/2023

PËR QEVERISJEN ELEKTRONIKE

(Ndryshuar me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësiwe të autoriteteve publike dhe/ose subjekteve private në lidhje me krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të infrastrukturës së informacionit, detyrimin e autoriteteve publike dhe/ose subjekteve private në zbatimin e standardeve të teknologjisë së informacionit, përcaktimin e rregullave për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, si dhe aksesin, përpunimin e protokollimin e dokumentit elektronik.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton:

- a) parimet e përgjithshme të qeverisjes elektronike;
- b) detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike;
- c) të drejtat e personave fizikë, subjekteve private dhe autoriteteve publike për të komunikuar me njëri-tjetrin përmes teknologjisë së informacionit;
- ç) funksionimin dhe ndërveprimin midis autoriteteve publike e subjekteve private për qeverisjen elektronike;
- d) infrastrukturën e shërbimeve elektronike;
- dh) sistemin e administrimit dhe protokollit të dokumentit elektronik për institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Neni 3
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet nga autoritetet publike dhe subjektet private për ushtrimin e kompetencave të tyre në ofrimin e shërbimeve publike në rrugë elektronike përmes përdorimit të sistemeve dhe rrjeteve të informacionit.

2. Ky ligj mundëson ofrimin në rrugë elektronike të shërbimeve publike për marrjen/përfitim të cilave nuk kërkohet domosdoshmëri paraqitja fizike e kërkuar.

3. Ky ligj nuk zbatohet për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, që rregullohen sipas ligjit të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Përkufizime

(Ndryshuar pika 37 dhe shtuar pika 47 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; shfuqizuar pika 21, shtuar pika 48 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “AKSHI” është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
2. “Kërkues” është çdo person fizik, subjekt privat apo autoritet publik që paraqet kërkesën elektronikisht në platformën qeveritare “e-Albania”.
3. “Autentifikimi” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
4. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për të drejtën e informimit.
5. “Autoriteti rregullator koordinues (ARK) i bazave të të dhënave shtetërore” është AKSHI.
6. “Blockchain” është teknologjia e regjistrave të shpërndarë në ndërtimin e një sistemi TIK.
7. “Cilësi dokumentare” nënkupton informacionin detyrues që i bashkëlidhet ose shoqëron dokumentin elektronik, të tillë si: nënshkrimi elektronik, koha e krijimit, emri i krijuesit dhe të dhëna të tjera që krijohen së bashku me dokumentin elektronik, me qëllim regjistrimin, ruajtjen e autenticitetit, tërësinë dhe vlefshmërinë e dokumentit elektronik përgjatë ciklit të dokumentimit.
8. “Cikël i dokumentit” nënkupton qarkullimin e dokumentit elektronik nga çasti i krijimit deri tek arkivimi ose asgjësimi i tij.
9. “Dokument elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
10. “Dokument shoqërues” është dokumenti i cili merret elektronikisht nëpërmjet SMDE-së nga një autoritet publik prej një autoriteti tjetër publik, si nevojë e përmbushjes së ofrimit të shërbimit.
11. “DLT” ose “Teknologjia e regjistrat të shpërndarë” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë.
12. “E-Rezidencë” është rezidenca virtuale që i jep të drejtë çdo shtetasi të huaj të regjistrohet si rezident në distancë për Republikën e Shqipërisë dhe të kryejë të gjitha proceset e nevojshme të të bërit biznes në Republikën e Shqipërisë, pa qenë e nevojshme prezenca fizike e shtetasit në Republikën e Shqipërisë.
13. “Identifikim elektronik i sigurt” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
14. “Informacion publik” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për të drejtën e informimit.
15. “Infrastruktura e ofrimit të shërbimeve elektronike”, është tërësia e pajisjeve fizike e sistemeve dhe infrastruktura fizike e ndërlidhur që mundëson ofrimin e shërbimeve elektronike.
16. “Inteligjenca artificiale” është simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nëpërmjet sistemeve dhe algoritmeve kompjuterike.
17. “Kod dydimensional” është logoja grafike e lexueshme nga sistemet kompjuterike, e cila përmban të dhëna dhe/ose informacione të koduara në format numerik, alfanumerik dhe binar.
18. “Nënshkrimi elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
19. “Nomadë digjitale” janë shtetasit e huaj që punojnë në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të regjistruar dhe punojnë kryesisht në distancë ose në lëvizje, të cilët përfitojnë statusin dhe përfitimet e “punonjësit lëvizës digjital”, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt apo kuadrit ligjor të posaçëm në Republikën e Shqipërisë.
20. “Ofrimi i shërbimeve elektronike” nënkupton ofrimin e shërbimit në formën e dërgimit dhe marrjes së të dhënave përmes sistemeve TIK, me kërkesë individuale të përdoruesit, pa qenë i pranishëm fizikisht.

21. Shfuqizuar.

22. “Përdorues” janë nëpunësit e autoriteteve publike, të cilët përdorin shërbime elektronike në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre dhe shtetasi, personi fizik ose juridik që përdor shërbimet elektronike.

23. “Përfitim i shërbimit elektronik publik” nënkupton përfitimën e shërbimit publik nga përdoruesi, i ofruar nëpërmjet sistemeve TIK.

24. “Platforma qeveritare ‘e-Albania’” është platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve elektronike (portali “e-Albania”).

25. “Platforma qeveritare e ndërveprimit” është sistemi që mundëson komunikimin midis bazave të të dhënave shtetërore, me qëllim ofrimin e shërbimeve elektronike.

26. “Protokolli elektronik (ERM)” është sistemi i informacionit që i shërben grumbullimit, regjistrimit dhe shpërndarjes së dokumenteve, të cilat qarkullojnë elektronikisht nëpërmjet këtij sistemi.

27. “Regjistrim” nënkupton deklarinë e vullnetit për përdorimin e shërbimeve elektronike, dorëzimin e dokumenteve shoqëruese dhe përfitimën e dokumenteve administrative me nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike.

28. “Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Elektronike Qeveritare” është regjistri që mbahet në përputhje me ligjin për bazat e të dhënave shtetërore.

29. “Siguria e sistemeve të informacionit” është tërësia e masave, politikave, procedurave, teknologjia dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave/elementeve të sistemit të informacionit, por edhe tërësisht nga çdo kërcënim i qëllimshëm apo i rastësishëm.

30. “*Single sign on*” është skema unike e identifikimit të përdoruesve, duke përdorur një ID dhe fjalëkalim të vetëm në platforma dhe sisteme të ndryshme të e-Qeverisjes për garantimin e besueshmërisë dhe të sigurisë në ofrimin e shërbimeve elektronike.

31. “Sistemi i Ruajtjes së Dokumentit Elektronik (SRDE)” përfshin tërësinë e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), të cilat përdoren për të menaxhuar ruajtjen dhe vënien në dispozicion të dokumenteve elektronike.

32. “Sistemi për dokumentet me vulë elektronike (SDVE)” është ndërfaqja ku kanë akses autoritete publike dhe/ose private për të aksesuar dokumentet elektronike me vulë elektronike, të cilat lëshohen nga autoritete publike dhe/ose private pas komunikimit përmes platformës qeveritare të ndërveprimit.

33. “SMA” është sistemi i menaxhimit të kërkesave.

34. “Smart Albania” është bashkësia e zgjidhjeve *software* dhe *hardware* që përdorin TIK për të përmirësuar eficiencën operacionale në funksion të informimit të publikut dhe rritjes së cilësisë së jetës dhe mirëqenies së shtetasve.

35. “SMDE” është Sistemi i Menaxhimit të Dokumentit Elektronik, që përfshin tërësinë e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), të krijuara në mënyrë specifike për të menaxhuar krijimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe vënien në dispozicion të dokumenteve, me qëllim që të sigurohet evidencë e aktiviteteve institucionale.

36. “Subjekt privat” është çdo person fizik dhe/ose juridik, shtetas shqiptar ose i huaj, që për të ofruar një shërbim publik në rrugë elektronike, ka të nevojshme përdorimin e të dhënave parësore të bazave të të dhënave të regjistruara pranë ARK-së.

37. “Shërbim publik elektronik” është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe të qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë në bazë të kërkesave të tyre dhe që rezulton në një përgjigje të formave të ndryshme, si: certifikatë, licencë, leje, vërtetim etj., nga institucioni përgjegjës i parashikuar në ligj.

38. “Shërbimet elektronike kategorizohen sipas 5 niveleve të zhvillimit të tyre”, si më poshtë:

a) niveli 1 nënkupton komunikimin e njëanshëm ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit, nëpërmjet ofrimit vetëm të informacionit për përfitimën e shërbimit publik;

b) niveli 2 nënkupton që, krahas informacionit për përfitimën e shërbimit publik, përdoruesit i shfaqet edhe mundësia e shkarkimit të formularit të kërkesës, të cilin e plotëson dhe e dorëzon

fizikisht në institucionin përkatës. Komunikimi ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit është i njëanshëm;

c) niveli 3 nënkupton ndërveprimin e dyanshëm ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit, duke i mundësuar këtij të fundit plotësimin dhe dërgimin elektronikisht të kërkesës;

ç) niveli 4 nënkupton ndërveprimin e dyanshëm të plotë ndërmjet institucionit publik e përdoruesit, duke i mundësuar këtij të fundit plotësimin dhe dërgimin elektronikisht të kërkesës, si dhe marrjen e përgjigjes elektronikisht nga institucioni, duke përfunduar të gjithë procedurën e shërbimit publik tërësisht *on-line*;

d) niveli 5 nënkupton që ofruesi i shërbimit ndërmerr veprime me qëllim për të ofruar shërbime të personalizuar për përdoruesin. Gjithashtu, ofruesi i shërbimit mund t'i ofrojë automatikisht shërbimet pa pasur nevojë që shtetasi të ndërmarrë veprime nga ana e tij.

39. “Shërbime të përqendruara” janë të gjitha shërbimet publike elektronike të ofruara nëpërmjet platformës unike qeveritare “e-Albania”.

40. “*Techspace*” është qendra teknologjike e ngritur nën administrimin dhe përgjegjësinë e AKSHI-t për mbështetjen e nomadëve digjitalë dhe studentëve në fushën TIK.

41. “TESTA” është Rrjeti i Shërbimeve Transeuropiane për Telematikën.

42. “Të dhënat e hapura” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

43. “TIK” është teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

44. “Transmetimi elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

45. “Vulë elektronike” janë të dhënat në formë elektronike, të cilat janë bashkëngjitur ose të lidhura logjikisht me të dhëna të tjera elektronike për të siguruar origjinën dhe integritetin e këtyre të fundit.

46. “Zhvillues i një sistemi në fushën TIK” është autoriteti publik/subjekti privat që ofron shërbime publike, i cili nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ofron apo realizon zgjidhje teknike.

47. “Riinxhinierim” është procesi që synon thjeshtëzimin e procedurave administrative të nevojshme për përfitimin e një shërbimi, të dokumentacionit përkatës apo të proceseve të tjera të lidhura me lëvrimin e shërbimit edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit.

48. “Shoqëri operatore TIK” është shoqëri aksionere, ku shteti zotëron të paktën 51 për qind të aksioneve për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, platformave dhe infrastrukturave të ofrimit të shërbimeve elektronike.

Neni 5

Parime të përgjithshme të qeverisjes elektronike

Qeverisja elektronike mbështetet në këto parime të përgjithshme:

- a) siguria e infrastrukturave të sistemeve të informacionit dhe shërbimeve të lidhura me të;
- b) ligjshmëria;
- c) mbrojtja e interesit të publikut;
- ç) paraqitja vetëm një herë;
- d) për të dhënat e hapura;
- dh) ndërtimi i infrastrukturës së qeverisjes elektronike;
- e) mbrojtja e të dhënave personale.

Neni 6

Parimi i paraqitjes vetëm një herë

Me qëllim lehtësimin e procedurave administrative për personat fizikë e juridikë, ofrimi i shërbimeve elektronike bazohet në parimin e paraqitjes së shtetasit “vetëm një herë” pranë autoriteteve publike dhe subjekteve private të të njëjtit informacion në përfitimin e shërbimeve elektronike, përmes ndërveprueshmërisë së sistemeve sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 7
Parimi për të dhënat e hapura

Me qëllim reduktimin e kostove, si dhe promovimin e zhvillimit të ekonomisë së të dhënave, autoritetet publike dhe subjektet private, në ofrimin e shërbimeve elektronike udhëhiqen nga parimi i sigurisë dhe ofrimi i “të dhënave të hapura”, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Neni 8
Parimi i ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike
(Ndryshuar shkurtetat në shkronjën “c” me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

Parimi i ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike nënkupton që zhvillimi i infrastrukturës së qeverisjes elektronike duhet të sigurojë:

- a) disponueshmërinë e të dhënave nga regjistrat publikë të të gjitha autoriteteve publike dhe subjekteve private për përfituesit e tjerë në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin e të dhënave, sigurinë e sistemeve të informacionit, rregullat për lirinë e informacionit;
- b) zhvillimin sistematik të vazhdueshëm të infrastrukturës qendrore të qeverisjes elektronike;
- c) mbrojtjen sistematike të vazhdueshme dhe sigurinë e infrastrukturës së qeverisjes elektronike në përputhje me rregullat mbi sigurinë, përfshirë garantimin e vazhdueshmërisë së biznesit (BC) dhe përballimin e fatkeqësive (DR);
- ç) zhvillimet e infrastrukturës së qeverisjes elektronike mbi bazën e nevojave dhe prioritetëve të harmonizuara;
- d) rregullimin dhe harmonizimin e planeve dhe projekteve të digjitalizimit në përputhje me standardet dhe udhëzimet e ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike sipas praktikave të Bashkimit Evropian;
- dh) ndërveprimin e sistemeve, përfshirë mundësimin e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikën e Bashkimit Evropian;
- e) racionalizimin e shpenzimeve dhe reduktimin e kostove për ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e përshkallëzuar sipas nevojës dhe ripërdorimin duke shmangur dublikimin e infrastrukturave;
- ë) garantimin e qëndrueshmërisë së investimeve me ndryshimet teknologjike dhe zhvillimin e kërkesave;
- f) ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të bazave të të dhënave të regjistruara;
- g) komunikimin nëpërmjet postës elektronike shtetërore në marrëdhënien qeveri-biznes-qeveri, qeveri-shtetas-qeveri;
- gj) përdorimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë për ruajtjen e pandryshueshme të të dhënave në sistemet elektronike;
- h) respektimin e standardeve të sigurisë elektronike.

KREU II
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETEVE PUBLIKE DHE SUBJEKTEVE
PRIVATE NË FUSHËN E QEVERISJES ELEKTRONIKE**

Neni 9
**Detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private për të zbatuar standardet
e teknologjisë së informacionit**

(Ndryshuar fjalë në shkronjën ‘‘ç’’ dhe pika 2, shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. Zhvilluesi i një sistemi në fushën TIK (autoritet publik apo subjekt privat) duhet:

a) të sigurojë që sistemet e teknologjisë së informacionit ta përpunojnë informacionin në mënyrë që të garantohet efikasiteti i ofrimit të shërbimeve;

b) të evidentojë sistemet ose pjesët e sistemeve, të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës dhe të ketë plane të dokumentuara për menaxhimin e riskut, teknikat e menaxhimit dhe të vlerësimit të performancës së tij. Me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave të menaxhimit të riskut, institucioni kryen auditime të brendshme;

c) të hartojë dokumentin e politikave të vazhdueshmërisë së punës dhe një plan për ruajtjen e informacionit në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga drejtori i përgjithshëm i AKSHI-it. Dokumenti i politikave të vazhdueshmërisë së punës duhet të përmbajë politikat dhe objektivat e përcaktuara për të siguruar vazhdimësinë e punës së këtyre sistemeve, të cilat administrohen nga institucioni ose palët e treta. Me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash, të hartojë një plan të rikuperimit nga katastrofa (*disaster recovery*), i cili përmban masa dhe procedura të mirëdokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave. Këto masa dhe procedura duhet të garantojnë, të paktën, një nivel minimal të shërbimit të sistemeve dhe funksioneve kritike. Procedurat duhet të përcaktohen në mënyrë që rivendosja në punë e sistemit të kryhet brenda harkut kohor të parashikuar në planin e rikuperimit nga katastrofa. Dokumenti i mësipërm duhet të marrë parasysh edhe disponueshmërinë e burimeve njerëzore në këto raste emergjencash, duke përcaktuar mënyrën e informimit dhe personat përgjegjës, të cilët do të ndjekin këto procedura;

ç) të specifikojë në dokumentin e politikave të vazhdueshmërisë së punës dhe në planin e rikuperimit nga katastrofa kohën maksimale të pranueshme, në të cilën shërbimet dhe sistemet mund të mos jenë funksionale;

d) të identifikojë të dhënat parësore dhe të dhëna të tjera, të cilat janë të rëndësishme për funksionimin e sistemit të tij të teknologjisë së informacionit.

dh) të identifikojë pajisjet e veçanta (*hardware*) dhe varësinë që sistemi, të dhënat dhe shërbimet kanë ndaj tyre. Të merren masa që dështimi i njëres prej këtyre pajisjeve të mos ndikojë në funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të ofruara;

e) të marrë masa që të dhënat e mësipërme, të cilat do të ruhen me qëllim rivendosjen e sistemeve dhe të shërbimeve në punë, të ruhen në një vendndodhje fizike dytësore e ndryshme nga ajo në të cilën ndodhen sistemet dhe të dhënat e institucionit gjatë veprimtarisë normale të tij.

2. Autoritetet publike/subjektet private, përgjegjëse për ofrimin e shërbimit elektronik, përpara vënies në punë të sistemeve apo të shërbimeve elektronike, janë të detyruara të përmbushin minimalisht standardet qeveritare të TIK-ut dhe standardet e shërbimeve publike elektronike (e-shërbimet), që miratohen me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t.

3. Shfuqizuar.

Neni 10

Detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private për të informuar në formë elektronike

1. Autoriteti publik/subjekti privat, përgjegjës për ofrimin e shërbimit elektronik, është i detyruar të ofrojë informacion për përdoruesit, për:

a) emrin e autoritetit publik/subjektit privat/ofruesit të shërbimit dhe, nëse nuk ka të tillë, emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë;

b) adresën e vendit në të cilin është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit;

c) adresën e postës elektronike shtetërore dhe/ose private apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit, ku përdoruesi mund të marrë informacion

në lidhje me shërbimet, këshilla dhe ndihmë për veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të marrë shërbimin;

ç) organin/autoritetin që ushtron kontroll mbi funksionimin e saj;

d) shërbimet publike të ofruara sipas modeleve të miratuara nga institucionet shërbimofruese;

dh) informacione të tjera të parashikuara në aktet rregullatore të fushës së të drejtës së informimit.

2. Kushtet e përdorimit dhe kufizimet e informacionit të publikuara në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike duhet të jenë të dukshme dhe të pasqyruara qartë. Ndryshimet në kushtet e përdorimit dhe kufizimeve duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë lehtësisht të identifikueshme në faqen zyrtare të internetit. Informacioni që publikohet në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike është i lirë të shkarkohet/të transferohet, të ruhet, të përpunohet, të shpërndahet dhe të përdoret, me kusht që të tregohet në mënyrë të qartë burimi i tyre dhe të mos paraqiten si informacione origjinale nëse kanë pësuar ndryshime.

3. Rregullat e detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike

(Shtuar togfjalësh në pikën 5 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. Autoritetet publike dhe subjektet private, të cilat janë përgjegjëse për ofrimin/realizimin e shërbimit publik sipas legjislacionit specifik sektorial, duhet të përmbushin kërkesat e këtij ligji për ofrimin e shërbimeve publike në rrugë elektronike në portalin “e-Albania”.

2. Autoritetet publike dhe subjektet private, të cilat janë përgjegjëse për ofrimin/realizimin e shërbimit publik, koordinojnë me AKSHI-n për realizimin e shërbimeve të automatizuara sipas këtij ligji përmes platformës qeveritare të ndërveprimit.

3. Autoritetet publike dhe subjektet private duhet të bashkëpunojnë me AKSHI-n për ofrimin e shërbimeve elektronike përmes platformës qendrore “e-Albania”.

4. Autoritetet publike dhe subjektet private, administruese të bazave të të dhënave shtetërore, zbatojnë detyrimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore dhe kërkesat e këtij ligji, për aq sa ato lidhen me ofrimin e shërbimeve elektronike.

5. Autoritetet publike kanë detyrimin që të bëjnë ruajtjen e të paktën një kopje të të dhënave shtetërore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Subjektet private kanë detyrimin që një kopje të të dhënave që ata disponojnë ta ruajnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Detyrimi për mbrojtjen e të dhënave personale

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

Autoritetet publike dhe subjektet private gjatë ofrimit të shërbimit elektronik duhet t'i përpunojnë të dhënat personale vetëm për qëllim të ofrimit të shërbimeve elektronike, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast të përpunimit të të dhënave personale ndërmerren dhe zbatohen masat e duhura teknike dhe organizative, duke garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Çdo veprim përpunimi i të dhënave personale gjatë aksesit/ndërveprimit me bazat e të dhënave shtetërore realizohet në përputhje me legjislacionin specifik dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rolet mbi kontrollin dhe përpunimin e të dhënave personale do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Komunikimi në formë elektronike për shërbime elektronike

1. Shtetasit, autoritetet publike dhe subjektet private:

a) kanë komunikim nëpërmjet postës elektronike shtetërore në marrëdhënien:

i. qeveri-biznes-qeveri;

ii. qeveri-shtetas-qeveri;

b) përdorin sistemet e TIK-ut, me qëllim ofrimin/përdorimin/marrjen e shërbimeve elektronike;

c) përdorin portalin “e-Albania” për kërkesat, dorëzimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuarit, kryerjen e pagesës elektronike, marrjen e shërbimit dhe dokumentet përfundimtare me nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike;

ç) japin dokumente elektronike të krijuara nga ata vetë me vulë elektronike dhe/ose nënshkrim elektronik.

2. Shërbimi në mënyrë elektronike ofrohet si alternativa e vetme për marrjen e shërbimit përmes portalit “e-Albania”, si pika e vetme e kontaktit që mundëson aksesin për kërkesë në shërbimet elektronike *on-line*, të ofruara nga administrata publike, duke i grupuar sipas kategorive të ndryshme.

Neni 14

Portali qeveritar “e-Albania”

1. Portali “e-Albania” është pika e vetme e kontaktit, e cila mundëson aksesin për kërkesë në shërbimet elektronike *on-line* të ofruara nga administrata publike, duke garantuar transaksionin elektronik të kryer, i cili gjeneron dokument elektronik.

2. Portali “e-Albania” ofron shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, si dhe të shërbimeve elektronike në portal dhe në modulën e tij për nëpunësit e administratës publike për çdo person fizik dhe juridik, që ushtron funksionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Portali “e-Albania” mundëson përmes platformës qeveritare të ndërveprimit shkëmbimin e të dhënave të sistemeve elektronike (baza të dhënash shtetërore) në përputhje me kushtet e siguruara si më poshtë:

a) çdo sistem elektronik (bazë të dhënash shtetërore) përdor shërbimin e dërgimit të të dhënave parësore (të cilat janë informacione specifike, të mbledhura në përputhje me aktin e krijimit të bazës së të dhënave) nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, duke pranuar transmetimin e këtyre të dhënave nga administratori i kësaj platforme;

b) transmetimi i të dhënave merret përsipër nga platforma në kohë reale dhe pa të drejtë përpunimi për shpërndarjen të marrësi i tyre me një mesazh të dhënash, që është shënuar në mënyrë elektronike dhe përmban datën dhe kohën e marrjes së tyre.

4. AKSHI/institucioni shërbimofruar kërkon ndryshimin e sistemeve dhe të proceseve elektronike në to, krijimin e shërbimeve të reja elektronike, me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore nga portali “e-Albania”, si dhe monitoron përdorimin dhe mbarëvajtjen e portalit.

KREU III

VLEFISHMËRIA E DOKUMENTIT ELEKTRONIK

Neni 15

Vlefshmëria ligjore e dokumentit elektronik

Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 16, 17 dhe 18 të këtij ligji.

Neni 16

Kriteret e dokumentit elektronik

Përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë:

- a) nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;
- b) të dhënat e krijuesit të dokumentit elektronik;
- c) pacenueshmërinë e dokumentit elektronik;
- ç) akses në përmbajtjen e dokumentit elektronik përgjatë gjithë ciklit të dokumentimit;
- d) qartësi në leximin e përmbajtjes së tij.

Neni 17

Struktura e dokumentit elektronik

Dokumentit elektronik përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe ajo e posaçme e tij, të cilat janë të pandashme:

a) pjesa e përgjithshme paraqet informacionin e përmbajtjes së dokumentit elektronik. Nëse dokumenti elektronik ka për qëllim t'i dërgohet një marrësi të përcaktuar, kjo pjesë përmban edhe emrin e marrësit;

b) pjesa e posaçme përfshin një apo disa nënshkrime elektronike dhe/ose vula elektronike dhe informacion, që i përkasin kohës së krijimit të dokumentit elektronik, si dhe të dhëna të tjera, që i përkasin cilësisë dokumentare, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 18

Forma e paraqitjes së dokumentit elektronik

Dokumentit elektronik ka formën e paraqitjes së tij të brendshme dhe formën e paraqitjes së jashtme:

a) forma e brendshme e paraqitjes së dokumentit elektronik është forma numerike, e përftuar nga përpunimi, dërgimi, marrja dhe ruajtja e dokumentit elektronik me një sistem programesh dhe pajisjesh kompjuterike;

b) forma e jashtme e paraqitjes së dokumentit elektronik është paraqitja vizuale dhe e kuptueshme e përmbajtjes së tij në ekranin e kompjuterit, në pajisje të tjera të ngjashme, në letër ose në mjete të tjera të materializuara, prodhuar nga forma e brendshme e paraqitjes sipas shkronjës “a” të këtij neni.

Neni 19

Uniciteti i dokumentit elektronik

1. Çdo dokument elektronik është unik.

2. Nëse i njëjti person përgatit dy apo më shumë dokumente elektronike, me përmbajtje të njëjtë, në formë elektronike, ose kur njëri prej të cilëve është krijuar në letër, këto dokumente trajtohen si të pavarura.

Neni 20

Kopja në letër e dokumentit elektronik

1. Vërtetimi i kopjes në letër i dokumentit elektronik nga institucionet publike kryhet nga personat e autorizuar nga titullari i institucionit.

2. Në të gjitha rastet e tjera, vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik kryhet nga noteri publik.

3. Kopja në letër, e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik, mban shënimin “Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”.

4. Rregullat dhe procedurat për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik, nëpërmjet vendosjes së një apo më shumë kodeve dydimensionale, përcaktohen me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t.

Neni 21

Fuqia ligjore e dokumentit elektronik dhe e kopjes së tij në letër

1. Dokumenti elektronik, si dhe kopja e tij në letër, e realizuar në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si dokumenti fizik.

2. Dokumenti elektronik, që plotëson kriteret e nenit 16 të këtij ligji, përdoret si provë.

3. Organi publik, që merr dokumentin elektronik si provë, përcakton vlefshmërinë e tij duke mbajtur parasysh të dhënat për përgatitjen, ruajtjen, transmetimin, sigurinë dhe autenticitetin e nënshkrimit elektronik dhe/ose vulës elektronike të tij, si dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

KREU IV

AUTORITETI PËRGJEGJËS I QEVERISJES ELEKTRONIKE, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Seksioni 1

Qeverisja elektronike

Neni 22

Autoriteti përgjegjës i qeverisjes elektronike

(Ndryshuar pika 3 dhe togfjalësh në pikën 4 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; shtuar togfjalësh në pikën 4 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. Autoriteti përgjegjës për qeverisjen elektronike është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në vijim AKSHI.

2. AKSHI është institucioni përgjegjës për infrastrukturën qendrore të shërbimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike të përqendruara, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për shërbimet publike.

3. Pranë AKSHI-t krijohet dhe funksionon Bordi Këshillimor për Teknologjinë e Informacionit, si organ konsultativ për çështjet e teknologjisë dhe informacionit.

4. Përbërja dhe rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Bordit Këshillimor për Teknologjinë e Informacionit dhe sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike.

Seksioni 2

Organizimi dhe funksionimi i AKSHI-t

Neni 23

Statusi i AKSHI-t

(Ndryshuar fjalia e parë e pikës 1, shtuar fjali në fund të pikës 1, hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. AKSHI është institucion i administratës shtetërore, me statusin e personit juridik publik buxhetor me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave. AKSHI organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e tij për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është

përgjegjës për ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë dhe informacionit ndaj personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe subjekteve private. AKSHI mund të themelojë “Shoqëri Operatore TIK” sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. AKSHI ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e AKSHI-t përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit”.

3. Vula e AKSHI-t ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 24

Përgjegjësitë e AKSHI-t

(Shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. AKSHI, në zbatim të misionit të tij, ka përgjegjësi si ofrues shërbimesh, si krijues e administrues i infrastrukturave të shërbimeve, sistemeve, portaleve, shërbimeve të besuara dhe regjistrave, si kontribues në hartimin e politikave e të planeve të veprimit në fushën TIK, si dhe detyra të tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji.

1/1. Për ushtrimin e funksioneve operative të zhvillimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve TIK, AKSHI mund të krijojë, të marrë pjesë ose të bashkëpunojë me shoqëri aksionere ku shteti zotëron të paktën 51 përqind të aksioneve, si dhe t’u kalojë atyre në administrim sisteme, platforma ose infrastruktura TIK dhe/ose t’i ngarkojë për zhvillimin dhe operimin e tyre nga fillimi.

Në çdo rast, kompetencat rregullatore, autoriteti publik dhe përgjegjësia institucionale mbeten tek AKSHI.

2. Për përmbushjen e detyrave të veta funksionale, AKSHI përdor burimet njerëzore për ofrimin e shërbimeve elektronike 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës.

Neni 25

Detyrat e AKSHI-t si ofrues shërbimesh

(Ndryshuar shkronja ‘c’ me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; ndryshuar shkronja ‘b’ e pikës 1 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

AKSHI, si ofrues shërbimesh, kryen detyrat e mëposhtme:

a) ofron shërbime të përqendruara *on-line* për shtetasit dhe për subjektet private përmes teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike dhe subjektet private;

b) ofron shërbime të përqendruara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si edhe për institucione të tjera publike, me kërkesë të vetë institucionit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive operatore TIK, sipas legjislacionit në fuqi;

c) ofron shërbimet e autentifikimit, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike dhe certifikatës elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike, dhe subjektet private, shtetasit shqiptarë dhe/ose të huaj, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave;

ç) mundëson ndërveprimin nëpërmjet portalit “e-Albania” dhe platformave të tjera, në funksion të përdorimit të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, të ofruara nga ofrues të kualifikuar të besuar, të legjitimuar në Republikën e Shqipërisë në shërbimet publike elektronike;

d) ngre dhe ofron shërbime elektronike për organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe subjekteve private, të cilat ofrojnë shërbime publike;

dh) garanton implementimin e masave të sigurisë kibernetike për të gjitha infrastrukturat kritike të informacionit në cilësinë e operatorit qeveritar që menaxhon këto infrastruktura;

e) merr masa administrative ndaj shkelësve apo keqpërdoruesve të portalit “e-Albania” sipas legjislacionit në fuqi.

Detyrat e AKSHI-t si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe i infrastrukturave

(Shtuar shkronja “k” me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

AKSHI si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe i infrastrukturave të shërbimeve, sistemeve, portaleve dhe regjistrave, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) është autoritet rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore;
 - b) rregullon dhe koordinon procesin e regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore me qëllim ekspozimin e të dhënave parësore në platformën qeveritare të ndërveprimit, auditimin e bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;
 - c) administron nga ana teknike çdo sistem TIK, që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave në përputhje me këtë ligj. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve, që përbëhen nga bazat e të dhënave, mbeten në administrimin e institucioneve respektive;
 - ç) mundëson ekspozimin e *web servise*-ve të bazave të të dhënave, me qëllim aksesimin e të dhënave parësore për subjektet e interesuara për ndërveprim në platformën qeveritare të ndërveprimit;
 - d) zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën qendrore të shërbimeve elektronike apo sistemet TIK;
 - dh) përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve e të aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave;
 - e) promovon teknologji të reja, harton strategji dhe plan-veprime për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOV;
 - ë) zhvillon politika e strategji në sektorin e shoqërisë së informacionit, në vijim SHI, dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në vijim TIK, si dhe nxit investimet në fushën e SHI-së;
 - f) zhvillon, administron dhe mirëmban shërbimet elektronike të ofruara përmes platformës qeveritare “e-Albania”;
 - g) zhvillon, administron dhe mirëmban sistemin “e-Rezidenca” për shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë në ndërveprim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile;
 - gj) administron qendrën teknologjike *Techspace* si kontribues në hartimin e politikave dhe planeve të veprimit në fushën TIK;
 - h) për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, AKSHI ndjek dhe zbaton politikat dhe strategjitë e hartuara nga institucioni përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar për këtë qëllim, i cili mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
 - i) administron kodin burim të çdo sistemi si përfaqësues i pronarit shtet që është Këshilli i Ministrave;
 - j) nxjerr nga përdorimi një sistem dhe/ose një infrastrukturë *hardware* dhe/ose *software* sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - k) ushtrimi i detyrave të parashikuara në shkronjat “c”, “d”, “dh”, “f” dhe “g” të këtij neni mund të realizohet nga AKSHI, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive operatore TIK në përputhje me këtë ligj.
- Në çdo rast autoriteti rregullator, përgjegjësia institucionale, si dhe pronësia mbi sistemet, infrastrukturën, kodin burimor dhe të dhënat mbeten te shteti dhe administrohen nga AKSHI.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të AKSHI-t, sisteme, platforma ose infrastruktura TIK ose pjesë të tyre mund t'u kalohen në administrim shoqërive operatore TIK për qëllime zhvillimi, operimi ose mirëmbajtjeje.

Kalimi në administrim nuk sjell transferim të pronësisë mbi këto sisteme dhe infrastruktura.

Neni 27

Detyrat e AKSHI-t si kontribues në hartimin e politikave në fushën TIK

(Ndryshuar shkronja "a" dhe shtuar shkronja "ë" me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

AKSHI, si kontribues në hartimin e politikave dhe planeve të veprimit në fushën TIK, kryen detyrat e mëposhtme:

a) përcakton standardet qeveritare të TIK-ut dhe standardet e shërbimeve publike elektronike (e-shërbimet) në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga institucionet e administratës shtetërore dhe subjektet private;

b) administron projektet në fushën TIK që zbatohen në të gjitha autoritetet publike dhe subjektet private sipas rastit, me fonde buxhetore ose jobuxhetore, financime apo donacione të huaja;

c) koordinon fondet e huaja dhe/ose donacionet në mbështetje të procedurave të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë për projektet në fushën TIK dhe është përgjegjës për procedurat e prokurimit dhe lidhjen e kontratës;

ç) kontribuon në hartimin e kuadrit ligjor për zhvillimin e shoqërisë së informacionit në fushën e komunikimeve elektronike e-GOV, si një nga komponentët e rëndësishëm të infrastrukturës TIK, si dhe zbaton politikat e strategjitë për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit;

d) kontribuon për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike në të gjithë sektorët e autoriteteve publike dhe subjekteve private;

dh) bashkërendon dhe koordinon procesin e mbetjeve elektronike dhe elektrike në respektim të parashikimeve të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

e) harton strategjinë e agjendës digjitale dhe bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës digjitale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike për shtetasit dhe subjektet private.

ë) harton Kornizën Kombëtare të Ndërveprimit në Republikën e Shqipërisë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Detyra të AKSHI-t në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare

AKSHI është pika hyrëse e Rrjetit të Shërbimeve Transeuropiane për Telematikën ndërmjet administratave në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë qëllim kryen detyrat e mëposhtme:

a) është përgjegjës për t'iu përgjigjur përdoruesve të *domain*-it të saj lokal, të cilët nuk janë të autorizuar të kontaktojnë drejtpërdrejt me mbështetjen qendrore të Rrjetit të Shërbimeve Transeuropiane për Telematikën ndërmjet Administratave;

b) merr masa për të lehtësuar ndërveprimin ndërmjet *domain*-it evropian dhe *domain*-it lokal;

c) merr të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për funksionimin operacional të *domain*-it;

ç) duhet të posedojë hapësirë të mjaftueshme dhe duhet të sigurojë të gjitha mjetet logjistike për komunikimin me rrjetin TESTA;

d) ndjek dhe zbaton detyrimet e ndërsjella, të përcaktuara në memorandumin e mirëkuptimit.

Neni 29

Detyra të tjera të AKSHI-t

(Shfuqizuar shkronja "h" me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; shfuqizuar shkronjar "dh", "e" dhe "ë", shtuar shkronja "i" dhe "j" me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

AKSHI, në funksion të përmbushjes së misionit të tij, kryen edhe detyrat e mëposhtme:

- a) harton politika, plane, strategji, si dhe ndërmerr përmirësimin dhe ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore për mbështetjen dhe zhvillimin e nomadëve digjitalë;
 - b) është përgjegjës për ngritjen e sistemit të “e-Rezidencës”;
 - c) përmirëson dhe përditëson sistemet TIK sipas teknologjisë *blockchain* kur vlerësohet e përshtatshme dhe e arsyeshme;
 - ç) është përgjegjës për implementimin e Smart-Albania në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - d) është struktura përgjegjëse për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në platformat ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
 - dh) shfuqizuar;
 - e) shfuqizuar;
 - ë) shfuqizuar;
 - f) ndërmerr, kryesisht ose mbi bazën e kërkesave të institucioneve të administratës shtetërore të interesuara, nisma për procesin e riinxhinierimit elektronik të shërbimeve nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, në varësi të nevojës për përmirësim të procedurave, riorganizimit të proceseve të punës, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të administratës publike, si edhe të zhvillimeve teknologjike;
 - g) jep mendim të detyrueshëm për institucionet publike, me qëllim zbatimin efektiv dhe bashkërendimin e projekteve në fushën e TIK-ut, si dhe bashkërendon projektet në fushën e SHI-së që zbatohen në të gjitha institucionet publike;
 - gj) jep mendim për institucionet e tjera të administratës publike, me kërkesë të tyre, për:
 - i. specifikimet teknike të prokurimeve që do të realizohen me fondet e buxhetit të shtetit, hua dhe/ose grante të dhëna nga donatorët;
 - ii. procedurat që kanë lidhje me projektpropozime/projekte të ndryshme, dhurata apo ndihma materiale;
- AKSHI jep mendim brenda afatit prej 20 ditësh pune nga data e marrjes së dokumentacionit.
- h) Shfuqizuar;
 - i) i propozon Këshillit të Ministrave kalimin në administrim për qëllim zhvillimi, operimi apo mirëmbajtjeje të infrastrukturës së ofrimit të shërbimeve elektronike tek “Shoqëria Operatore TIK”;
 - j) procedurat e prokurimit publik, përfshirë ato në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), zhvillohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Neni 30

Organet drejtuese të AKSHI-t

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. AKSHI drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie.
2. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga dy zëvendës drejtorë.

Neni 31

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së AKSHI-t;
- b) ushtron kompetencat në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- c) emëron personelin e nevojshëm sipas kritereve të përcaktuara, si dhe administron burimet njerëzore e kualifikimet tyre;

- ç) përfaqëson AKSHI-n në marrëdhëniet me të tretët;
- d) negocion dhe nënshkruan marrëveshje strategjike me autorizim të Këshillit të Ministrave;
- dh) nxjerr urdhra dhe udhëzime në fushën e TIK-ut;
- e) kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë ligj.

Neni 32

Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i drejtorit të përgjithshëm

(Shtuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. Drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike. Drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademikë ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë në fushën e teknologjisë së informacionit;
- ç) të ketë përvojë drejtuese të paktën 5 vjet në administratën publike ose në fushën e menaxhimit të projekteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- d) të ketë integritet moral dhe profesional;
- dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

2. Drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t lirohet nga detyra, kur:

- a) plotëson kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;
- b) deklarohej i paaftë për punë nga komisioni kompetent;
- c) ristrukturohet institucioni;
- ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm të interesit;
- d) jep dorëheqjen nga detyra;
- dh) humbet ose lë shtetësinë shqiptare.

3. Drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t shkarkohet nga detyra, kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- b) i shkakton, për shkak të paafësisë profesionale a të neglizhencës, dëm institucionit ose imazhit të tij;
- c) nuk përmbush objektivat strategjike për shkak të performancës së ulët të tij;
- ç) kryen shkelje të rënda të detyrës.

Neni 33

Administrata e AKSHI-t

(Shtuar togfjalësh në pikën 4 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. Struktura dhe organika e AKSHI-t miratohen me urdhër të Kryeministrit sipas përcaktimeve në fuqi të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore.

2. Rekrutimi i nëpunësve të AKSHI-t bëhet nëpërmjet procedurave transparente dhe jodiskriminuese dhe bazuar në kërkesat e përshkrimeve të punës, të përcaktuara në rregulloren që miraton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKSHI-t.

3. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të AKSHI-t rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

4. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKSHI-t miratohet nga Kryeministri apo ministri përgjegjës për qeverisjen elektronike, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm.

Neni 34

Trajtimi me pagë i nëpunësve të AKSHI-t

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024; shtuar togfjalësh në fund të fjalisë së parë me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

Niveli i pagës së nëpunësve të AKSHI-t përcaktohet sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në masën deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë në muaj.

Drejtori i përgjithshëm dhe nëpunësit e njësive teknike të përmbajtjes së AKSHI-t, përveç pagës sipas kategorive të pagës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune. Masa e shtesës për natyrë të veçantë për secilën kategori përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

Burimet e financimit të AKSHI-t

Burimet e financimit të AKSHI-t janë:

- a) buxheti i shtetit;
- b) të ardhura të tjera nga projekte, hua ose donacione, të marra në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën përkatëse;
- c) burime të tjera të ligjshme.

Neni 36

Tarifat e shërbimeve

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

1. Tarifat e mbledhura nga ofrimi i shërbimeve të AKSHI-t në zbatim të këtij ligji, të shërbimeve të përcaktuara në ligjin për nënshkrimin elektronik dhe shërbimet e besuara derdhen në buxhetin e shtetit.

2. Llojet e tarifave sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni dhe masa e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pagesat që institucionet publike përfituese kryejnë ndaj shoqërive operatore TIK, në bazë kontratash shërbimi, nuk përbëjnë tarifa publike dhe rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

INFRASTRUKTURA E SISTEMEVE TIK DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 37

Infrastruktura e sistemeve TIK dhe e shërbimeve elektronike

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën “dh” me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. Infrastruktura e shërbimeve elektronike mundëson ndërveprimin në kohë reale të bazave të të dhënave të regjistruara. Infrastruktura e shërbimeve elektronike përfshin:

a) platformën unike qeveritare “e-Albania”, platformën qeveritare të ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve elektronike sipas tipologjisë: qeveri-qeveri (G2G), qeveri – shtetas (G2C), qeveri – biznes (G2B);

b) Regjistrin Kombëtar të Shërbimeve të Bazave të të Dhënave të Regjistruara;

- c) Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave të Regjistruara;
 - ç) qendrën e të dhënave qeveritare (*Datacenter-in* Qeveritar);
 - d) qendrën e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së *Datacenter-it* qeveritar në rast fatkeqësie (*Disaster Recovery Center*);
 - dh) qendrën e vazhdueshmërisë së punës (*Business Continuity Center*, BCC) dhe sistemet e ruajtjes së informacionit (*backup systems*), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës;
 - e) rrjetin qeveritar (Govnet);
 - ë) çelësin publik dhe menaxhimin e certifikatave digjitale për administratën shtetërore dhe subjektet private;
 - f) sistemin e administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik;
 - g) platformën qeveritare të pagesave elektronike në portalin “e-Albania”;
 - gj) sistemin e dokumenteve me vulë elektronike;
 - h) sistemin “e-Rezidenca”;
 - i) çdo infrastrukturë tjetër që mund të ngrihet në kuadër të qeverisjes elektronike.
2. Për sigurinë e informacionit dhe sistemeve, kur ato janë të klasifikuara, zbatohen detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 38

Përdorimi i teknologjisë së regjistrave të shpërndarë

Bazat e të dhënave të regjistruara me nivel të lartë sigurie ngrihen me teknologjinë e regjistrave të shpërndarë.

Neni 39

Përdorimi i teknologjisë së inteligjencës artificiale

1. Teknologjia e inteligjencës artificiale aplikohet, aty ku është e mundur, në sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim rritjen dhe inovacionin në ekonominë digjitale.
2. Metodologjia dhe standardet teknike të përdorimit të kësaj teknologjie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40

Sistemi “e-Rezidenca” për shtetasit e huaj

1. “E-Rezidenca” është sistemi TIK, i cili u mundëson shtetasve të huaj që nuk kanë leje qëndrimi në Shqipëri të paraqesin kërkesë për ID digjitale, pa qenë nevoja e paraqitjes fizike.
2. Shtetasi i huaj ka të drejtë, por pa u limituar në:
 - a) kërkesën për t’u pajisur me një identitet virtual pranë një konsullate, ku paraqitet vetëm një herë;
 - b) kërkesën *on-line* për marrjen e rezidencës elektronike;
 - c) kërkesën për regjistrimin e një subjekti privat pranë institucionit që mbulon regjistrimin e biznesit, si dhe ta menaxhojë atë nëpërmjet internetit;
 - ç) kërkesën për regjistrimin si nomad digjital;
 - d) të ketë mundësi për të aksesuar tek ofruesit e shërbimeve ndërkombëtare të pagesave;
 - dh) të nënshkruajë dhe të transmetojë dokumente në mënyrë digjitale.
3. ID digjitale e e-Rezidentit mund t’i jepet një personi në përputhje me ligjin për dokumentin elektronik, i cili ka një interes të justifikuar në përdorimin e shërbimeve elektronike të shtetit shqiptar, pavarësisht nëse ka ose jo leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.
4. Procedura e krijimit të regjistrat elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhe dokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin,

vlerësimin dhe miratimin e kërkesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

Neni 41

Posta elektronike shtetërore (PESH)

1. Posta elektronike shtetërore është mënyra e vetme e komunikimit elektronik zyrtar në marrëdhënien qeveri-shtetas-qeveri, qeveri-biznes-qeveri.
2. Adresa e postës elektronike shtetërore krijohet automatikisht:
 - a) për shtetasin sipas modelit Numerunic@e-Albania.al;
 - b) për autoritetet publike dhe subjektet private sipas modelit NumerNUIS@e-Albania.al.
3. Komunikimi që shkëmbehet nëpërmjet PESH-së mban të njëjtën vlerë ligjore si njoftimi shkresor.
4. Çdo përdorues i PESH-së është përgjegjës për kontrollin e njoftimeve të reja maksimumi çdo 48 orë nga momenti i mbërritjes së njoftimit.
5. Adresa e PESH-së është mënyra e vetme e kontaktit në portalin “e-Albania”, duke zëvendësuar postën elektronike private edhe për llogaritë ekzistuese të regjistruara në platformë.

Neni 42

Qendra e të dhënave qeveritare

1. Qendra e të dhënave qeveritare është njësia qendrore e të dhënave qeveritare, e cila mundëson infrastrukturën dhe kushtet e nevojshme për realizimin e shkëmbimit dhe koordinimit të bazave të të dhënave shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.
2. Çdo autoritet publik apo subjekt privat, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për shtetasit, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (*Business Continuity*), sistemit të rikuperimit nga fatkeqësia (*Disaster Recovery*) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (*Backup*), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave. Autoriteti publik gjatë projektimit të këtyre sistemeve duhet të parashikojë që nyja primare të hostohet pranë Qendrës së të Dhënave Qeveritare dhe nyja sekondare të hostohet pranë Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës (*Business Continuity Center*).

Neni 43

Të dhënat e hapura

1. Me qëllim krijimin e produkteve të reja të informacionit dhe shërbimeve, të cilat kanë si bazë informacionet dhe të dhënat që gjenden në portalin opendata.gov.al, si dhe për promovimin e zhvillimin e ekonomisë së të dhënave, autoritetet publike dhe AKSHI u ofrojnë personave fizikë dhe juridikë të drejtën e ripërdorimit të informacionit që prodhohet dhe mbahet nga autoritetet publike si pjesë e të dhënave të hapura.
2. Autoriteti përgjegjës për mbledhjen e tarifave, masa e këtyre tarifave dhe mënyra e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pagesa duhet të jetë transparente dhe jodiskriminuese.

Neni 44

Faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike dhe subjekteve private

1. Autoritetet publike kanë detyrimin të krijojnë dhe të mirëmbajnë faqen e tyre zyrtare të internetit, lehtësisht të aksesueshme për ofrimin e informacionit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

2. Autoritetet publike dhe subjektet private garantojnë saktësinë, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e informacioneve që postojnë apo njoftojnë për postim në platformën unike qeveritare. Autoritetet publike dhe subjektet private janë përgjegjëse për përditësimin e informacioneve dhe shërbimeve që ofrojnë. Në çdo rast, informacioni i publikuar mban datën e përditësimit më të fundit të saj.

3. Përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, faqet zyrtare të institucioneve publike, janë faqe të lira dhe pa kufizime në akses.

KREU VI OFRIMI DHE PËRFITIMI I SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE DHE DOKUMENTIT ELEKTRONIK ADMINISTRATIV

Neni 45

Ofrimi i shërbimeve elektronike informative

Ofrimi i shërbimeve elektronike informative është i hapur për çdo përdorues. Ai ofrohet pa pasur nevojë për regjistrim dhe identifikim të marrësit të shërbimit.

Neni 46

Përfitimi i shërbimit elektronik publik me regjistrim dhe identifikim

1. Ofrimi i shërbimeve elektronike joinformative apo kërkesa për marrjen e një dokumenti elektronik administrativ bëhet vetëm pasi kryhet regjistrimi dhe autentifikimi i përdoruesit. Origjinaliteti i kërkesës vërtetohet në mënyrë elektronike në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

2. Kërkesa e kryer përmes portalit “e-Albania”, pas verifikimit, i përcillet elektronikisht përmes platformës qeveritare të ndërveprimit autoritetit publik ose subjektit privat përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e shërbimit elektronik apo për lëshimin e dokumentit elektronik administrativ. Dhënia e shërbimit kryhet sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionit të posaçëm që rregullon shërbimin e kërkuar.

3. Përpara procesit të regjistrimit, personat informohen për qëllimet e mbledhjes dhe përpunimin e të dhënave personale në kuadër të ofrimit të shërbimeve elektronike.

Neni 47

Zhvillimi dhe implementimi i shërbimeve elektronike dhe komunikimi i sistemeve

1. Autoritetet publike dhe subjektet private ofrojnë shërbimet elektronike përkatëse në portalin “e-Albania” nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit në rastet kur shërbimi ka të detyrueshme përdorimin e të dhënave që gjenden në baza të dhënash shtetërore.

2. Zhvillimi dhe implementimi i shërbimeve elektronike që ofrohen në portalin “e-Albania” bëhet nga AKSHI sipas modelit *backend as a service* (BAS).

3. Çdo shërbim elektronik duhet të implementohet në atë mënyrë që të dhënat, që ekzistojnë në baza të dhënash të regjistruara pranë ARK-së, të mund të plotësohen automatikisht paraprakisht nga ndërveprimi mes sistemeve.

4. Komunikimi i sistemeve dhe shërbimeve për të dhënat e kërkuara kryhet nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, në mënyrë të sigurt, sipas legjislacionit në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ofrimi i shërbimeve elektronike përmes portalit “e-Albania” bëhet në bashkëpunim me autoritetet publike dhe subjektet private përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve respektive, ku këto të fundit propozojnë kërkesat funksionale për dhënien e shërbimit.

6. Kërkesat funksionale që propozohen nga autoritetet publike dhe subjektet private për implementimin e shërbimeve në portalin “e-Albania” miratohen nga AKSHI përpara fillimit të zhvillimit dhe implementimit të shërbimit.

7. Subjektet private ofrojnë shërbimet elektronike respektive nëpërmjet platformës qeveritare të dedikuar të ndërveprimit, në rastet kur shërbimi ka të detyrueshme përdorimin e të dhënave që gjenden në baza të dhënash shtetërore.

Neni 48

Përmbajtja e dokumenteve elektronike administrative

Dokumentet elektronike administrative duhet të përmbajnë:

a) të dhënat e kërkuara prej kërkuesit, të cilat përfitohen nga transmetimi elektronik nga sistemi që disponon bazën e të dhënave;

b) vulën elektronike dhe/ose nënshkrimin elektronik të gjeneruar nga një certifikatë e kualifikuar të institucionit lëshues (AKSHI);

c) formën vizuale të vulës elektronike dhe/ose nënshkrimit elektronik, të përcaktuar sipas këtij ligji;

ç) shënimin në fund të faqes “Ky dokument është lëshuar nga sistemi elektronik me procedurë automatike dhe garantohej nga transmetimi elektronik dhe vula elektronike” në rastin e dokumentit elektronik administrativ të lëshuar me vulë elektronike.

Neni 49

Vlefshmëria ligjore

1. Dokumentet elektronike administrative, që përfitohen nga bazat e të dhënave shtetërore përmes transmetimit elektronik të të dhënave, me nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike, kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.

2. Autoriteti publik dhe personat fizikë e juridikë nuk kanë të drejtë të refuzojnë një dokument administrativ të gjeneruar në rrugë elektronike dhe të ofruar në portalin “e-Albania” nga autoritetet publike ose subjektet private.

3. Transmetimi elektronik i të dhënave kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Neni 50

Shkëmbimi dhe qarkullimi i dokumentit elektronik për administratën shtetërore

Shkëmbimi dhe qarkullimi i dokumentit elektronik ndërmjet institucioneve të administratës publike në nivel qendror kryhet nëpërmjet postës elektronike shtetërore dhe sistemit të administrimit të dokumentit elektronik.

Neni 51

Pagesa elektronike

1. Për marrjen e shërbimeve publike elektronike AKSHI ofron mundësinë e pagesës elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet platformës së pagesave në portalin “e-Albania”. Portali “e-

Albania” ofron mundësinë e pagesës elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë e të pavarur nga platformat elektronike të pagesave nga institucionet financiare.

2. Pagesat elektronike kryhen sipas rregullave të miratuara në legjislacionin në fuqi për instrumentet e pagesave.

Neni 52

Shërbimet elektronike të ofruara nga subjektet private

1. Për ofrimin e shërbimeve elektronike nga subjektet private, AKSHI ngre platformën elektronike dhe mundëson pagesën elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet platformës së pagesave të ngritur nga AKSHI e të pavarur nga platformat elektronike të pagesave nga institucionet financiare.

2. Ofrimi i shërbimeve elektronike në platformë ofrohet si mënyrë alternative.

3. AKSHI aplikon tarifa për subjektet që zgjedhin ofrimin e shërbimeve elektronike publike në platformë.

4. Mënyra e ofrimit të shërbimeve elektronike për subjektet private përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 53

Vlerësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit

1. Çdo person, që ka paraqitur kërkesë në portalin “e-Albania”, gëzon të drejtën për të vlerësuar pas kërkesës dhe/ose pas marrjes së shërbimit cilësinë dhe performancën e platformës dhe shërbimit konkret.

2. AKSHI krijon dhe mirëmban një rubrikë për vlerësimet për shërbimet e ofruara nëpërmjet platformës elektronike.

3. Në rast se vlerësimi është bërë për shërbimin e kërkuar, atëherë AKSHI ua komunikon në rrugë elektronike strukturave përkatëse të institucionit publik ose subjektit privat përgjegjës për ofrimin e shërbimit, i cili përgjigjet brenda 10 ditëve punë, nëse legjislacioni i posaçëm nuk parashikon afate të ndryshme. Në çdo rast, vlerësuesi njoftohet se cili institucion është duke shqyrtuar vlerësimin e tij.

Neni 54

Zhvillimi i projekteve TIK për administratën publike

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. Projektet TIK në administratën publike zhvillohen dhe projektohen duke garantuar ndërveprueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

2. Shfuqizuar.

Neni 55

Kundërvajtjet administrative

1. Mospërmbushja e detyrimeve sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 11 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5.000.000 (pesë milionë) lekë deri në 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Në konstatimin e shkeljes, marrjen e vendimit dhe përcaktimin e masës së gjobës për çdo kundërvajtje, AKSHI zbaton legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Të ardhurat nga gjobat sipas pikës 1 të këtij neni derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 56
Ankimi gjyqësor

Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 57
Nxjerrja e akteve nënligjore
(Hegur dhe shtuar fjalë në pikën 1 dhe shtuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 100, datë 12.9.2024)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve, 10, pika 3, 27, shkronja “ë”, 34, 36, pika 2, 39, pika 2, 40 pika 4, 43, pika 2, 52, pika 4 të këtij ligji.
2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim dhe të pikës 2, të nenit 9, të pikës 4 të nenit 20 të këtij ligji.

Dispozita kalimtare
(e ligjit nr. 100, datë 12.9.2024)

Trajtimi i punonjësve ekzistues të ADISA-s do të bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon marrëdhënien e tyre të punës.

Dispozita kalimtare
(e ligjit nr. 25/2026, datë 20.2.2026)

Procedurat e prokurimit të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre.

Neni 58
Shfuqizime

1. Ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit mbeten në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj.

Neni 59
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 96, datë 3.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.